



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-134

Prishtinë, më 18 nëntor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 18 NËNTOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Goran Marinkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë të mbajtura më 11 dhe 14 nëntor 2013,
2. Pikat e mbetura nga mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, e datës 11.11. 2013,
3. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 11 dhe 14 nëntor 2013

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 11 dhe 14 nëntor 2013.

2. Pikat e mbetura nga mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, e datës 11.11. 2013

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me pikat e papërfunduara nga mbledhjet plenare të mëparshme:

- *Votimi i raportit të Komisionit Qendror për Privatizimin e 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës dhe*
- *Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës.*

Për pikat e papërfunduara diskutuan: Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së dhe Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas këtyre diskutimeve, vendosi që dy pikat e lartshënuara të shtyhen për ndonjë seancë tjetër të Kuvendit.

3. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pas shqyrtimit të përgatitjeve të nevojshme për seancën plenare të radhës, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 21 nëntor 2013, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014,*
- 5. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fshatin Zym i Hasit,*
- 7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave.*

Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

- 1. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare për Radio Televizionin e Kosovës*

Kryesia, pasi diskutoi përsëri lidhur me vendimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta rishqyrtojë kërkesën e Radiotelevizionit të Kosovës për transferimin e mjeteve buxhetore për RTK-në, në shumën prej 1 000 000 euro, të ndara sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe seancës plenare t'ia paraqesë raportin me rekomandim.

- 2. Kërkesa për mbështetje financiare për shërimin e ish-zëvendësministrit, Raif Elezi*

Kryesia u njoftua nga nënkryetari i Kuvendit, Albert Kinolli, se ish-zëvendësministri Raif Elezi kishte ndërruar jetë. Andaj, kërkesa e lartshënuar është pa objekt.

Pika shitesë:

1. Njoftimi për ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Kryesia, pasi u njoftua me shkresën e ministres për Integritet Evropian, Vlora Çitaku, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të përgatisë raport për procesin e integritetit evropian të Kosovës, përfshirë edhe ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili do të shqyrtohet në seancë plenare të Kuvendit gjatë muajit dhjetor 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale